

VENDIM
Nr. 19, datë 28.4.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË PIKËN “2 GERMA ‘b’” TË VENDIMIT TË KOMISIONIT
KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 160, datë 30.12.2020 “PËR LICENCIMIN E SHA
UJËSJELLËS-KANALIZIME MALËSI E MADHE”**

Në mbështetje të nenit 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (ligji nr. 8102); VKM-së nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë” (VKM-së nr. 958); si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009, “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar (Rregullore e licencimit),

KOMISIONI KOMBËTAR RREGULLATOR,

në mbledhjen e datës 28.4.2023, pasi shqyrtoi çështjen me objekt “Mbi miratimin e vendimit ‘Për një ndryshim në pikën 2 germa “b”, të vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 160, datë 30.12.2020, ‘Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Malësi e Madhe’””,

VËREN SE:

1. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Malësi e Madhe (UK Malësi e Madhe), me shkresën nr. 222 prot., datë 13.4.2023, me lëndë “Njoftim në lidhje me ndryshimin e drejtuesit teknik të sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Malësi e Madhe”, ka paraqitur pranë ERRU-së kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe rregullores së licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Malësi e Madhe për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe rregulloren e licencimit.

3. KKRR-ja ka licencuar shoqërinë UK Malësi e Madhe me vendimin nr. 160, datë 30.12.2020, “Për licencimin e sh.a. Ujësjiellës-Kanalizime Malësi e Madhe”, me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

4. Drejtues teknik i shoqërisë UK Malësi e Madhe sh.a. z. Gëzim Isufaj ka mbaruar studimet e larta në Inxhinieri ndërtimi në vitin 1993.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit teknik ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Malësi e Madhe sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojë, në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojë interesat e konsumatorëve, në lidhje me cilësinë, eficiencën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Malësi e Madhe është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën “2 b” të vendimit të KKRR-së nr. 160, datë 30.12.2020, “Për licencimin e sh.a., Ujësjiellës-Kanalizime Malësi e Madhe”, bëhet ndryshimi. si më poshtë:

“Drejtues teknik: Gëzim Isufaj.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Ndriçim Shani